

**Marrëveshje Administrative për zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së
Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane për Mbrojtjen Shoqërore**

Në zbatim të Nenit 20, Paragrafi (1) i Marrëveshjes së datës 18 Shkurt 2022 ndërmjet
Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane për Mbrojtjen Shoqërore, më tutje e
quajtur «marrëveshja», autoritetet kompetente:

për Republikën e Shqipërisë

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

dhe

për Konfederatën Zvicerane

Zyra Federale për Sigurimet Shoqërore

bien dakord për dispozitat si vijon:

26

KREU I
Dispozitat e përgjithshme

Neni 1
Përkufizimet

Termat e përdorura në këtë marrëveshje administrative kanë kuptimin e njëjtë si në marrëveshje.

Neni 2
Zyrat ndërlidhëse dhe institucionet kompetente

Zyrat ndërlidhëse në kuptim të Nenit 20, Paragrafi (1) të marrëveshjes, janë:

1.1 në Shqipëri:

Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

1.2 në Zvicër:

- për sigurimin e pleqërisë dhe atë familjar:

Zyra Zvicerane e Kompensimit (Schweizerische Ausgleichskasse) në Gjenevë (më poshtë e quajtur «Zyra Zvicerane e Kompensimit»

- për sigurimin e invaliditetit:

Zyra e sigurimit të invaliditetit në Gjenevë për të siguruarit me vendbanim jashtë Zvicrës (IV-Stelle für Versicherte mit Wohnsitz im Ausland in Genf).

(2) Institucionet kompetente janë:

2.1 në Shqipëri

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

2.2 në Zvicër:

- për sigurimin e pleqërisë dhe atë familjar:

Zyra kompetente e Kompensimit,

- për sigurimin e invaliditetit:

Zyra kompetente për Sigurimin e Invaliditetit.

Neni 3

Formularët dhe shkëmbimi elektronik i të dhënave

(1) Autoritetet kompetente të dy shteteve kontraktuese, ose me autorizimin e tyre zyrat ndërlidhëse përcaktojnë në mirëkuptim të dyanshëm formularët e nevojshëm për zbatimin e marrëveshjes.

(2) Me qëllim lehtësimin e zbatimit të marrëveshjes, zyrat ndërlidhëse mund të marrin masa për shkëmbimin elektronik të të dhënave.

KREU II

Legjislacioni i zbatueshëm

Neni 4

Personat e dërguar

(1) Në rastet sipas Nenit 7 Paragrafi (1) të marrëveshjes, institucionet kompetente të shtetit kontraktues të përmendur në paragrafin (2) të këtij neni, legjislacioni i të cilit zbatohet në vazhdim, vërtetojnë, kur kjo kërkohet, se personi në fjalë vazhdon t'i nënshtrohet atij legjislacioni.

Vërtetimi përmban periudhën e vlefshmërisë së tij dhe sipas marrëveshjes është dëshmi, që personi nuk i nënshtrohet sigurimit të detyrueshëm të shtetit tjetër kontraktues.

(2) Vërtetimi sipas Paragrafit (1) të këtij neni lëshohet në formularin e parashikuar, si në vijim:

2.1 në Shqipëri nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;

2.2 në Zvicër nga Zyra Kompetente e Kompensimit për sigurimin e pleqërisë, atë familjar dhe të invaliditetit;

(3) Kërkesa për zgjatjen e periudhës së dërgimit përtej dy viteve të parashikuara në marrëveshje, duhet të dorëzohet përpara skadimit të afatit të vërtetimit pranë autoritetit kompetent të shtetit kontraktues, nga territori i të cilit është dërguar personi. Nëse ky autoritet e pranon kërkesën, atëherë ai e dakordëson përmes komunikimit të shkruar me autoritetin kompetent të shtetit tjetër kontraktues, si dhe njofton personin aplikues dhe institucionet kompetente të shtetit të tij mbi vendimin.

Neni 5

Të punësuarit në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

(1) Personat sipas nenit 10, paragrafi (2) të marrëveshjes paraqesin dëshmi, që ata vazhdojnë t'i nënshtrohen legjislacionit të shtetit nga i cili janë dërguar, përmes një dokumenti në përputhje me Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike të datës 18 prill 1961 dhe në përputhje me Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore të datës 24 prill 1963.

(2) Për të zbatuar të drejtën e tyre të zgjedhjes sipas nenit 10, paragrafet (3) dhe (4) të marrëveshjes,:

2.1 të punësuarit në Shqipëri e deklarojnë zgjedhjen e tyre në Zyrën Federale në Bernë;

2.2 të punësuarit në Zvicër e deklarojnë zgjedhjen e tyre në Institutin e Sigurimeve Shoqërore në Shqipëri.

(3) Nëse të punësuarit sipas nenit 10, paragrafet (3) dhe (4) të marrëveshjes zgjedhin legjislacionin e shtetit që përfaqësojnë, atëherë nga institucioni apo institucionet kompetente të atij shteti kontraktues u lëshohet një vërtetim, i cili konfirmon që ata i nënshtrohen legjislacionit të atij shteti. Ky vërtetim duhet t'u paraqitet institucioneve kompetente të shtetit kontraktues, ku ushtrohet veprimtaria.

(4) Në rastet e parashikuara sipas nenit 10, paragrafi (7) i marrëveshjes, personat në fjalë regjistrohen pranë institucioneve kompetente të shtetit ku ushtrojnë veprimtarinë, si në rastin kur fillojnë punë me hyrjen në fuqi të marrëveshjes ashtu edhe në rastin kur ata kanë filluar veprimtarinë para hyrjes në fuqi të marrëveshjes dhe nuk janë të siguruar.

Neni 6

Anëtarët e familjes

Në rastet e parashikuara sipas nenit 13, paragrafi (2) i marrëveshjes personat në fjalë paraqiten tek Zyra e Kompensimit e kantonit, në territorin e të cilit ata kanë jetuar së fundmi.

23

KREU III

Dispozitat mbi përfitimet

Neni 7

Paraqitja dhe shqyrtimi i kërkesave për përfitim

(1) Personat të cilët jetojnë në Zvicër dhe paraqesin kërkesë për pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar sipas legjislacionit shqiptar, kërkesën e tyre e dërgojnë drejtëpërdrejtë tek Zyra Zvicerane e Kompensimit. Zyra Zvicerane e Kompensimit, vendos

në formular datën e dorëzimit të kërkesës, verifikon nëse kërkesa është e plotë, kontrollon nëse të gjitha dokumentacionet përkatëse për identifikimin dhe dokumentet e tjera zyrtare janë të bashkëngjitura dhe vërteton vlefshmërinë e dokumenteve zyrtare të bashkëngjitura. Zyra Zvicerane e Kompensimit më pas ia përcjell kërkesën, kopjet e dokumenteve identifikuese dhe dokumentacionin zyrtar të bashkëngjitur si dhe formularët përkatës të periudhës së sigurimit institucionit kompetent shqiptar. Ky institucion mund të kërkojë nga Zyra Zvicerane e Kompensimit ose drejtëpërdrejtë nga personi që ka paraqitur kërkesën ose tek punëdhënësi apo institucionet e tjera, vërtetime dhe informacione shtesë në mënyrë që të sigurojë këto të dhëna.

(2) Personat të cilët jetojnë në Shqipëri dhe bëjnë kërkesë për pension zviceran pleqërie, familjar apo invaliditeti, paraqesin kërkesën drejtëpërdrejtë tek Instituti i Sigurimeve Shoqërore në Shqipëri. Ky institucion vendos në formular datën e paraqitjes së kërkesës, verifikon nëse kërkesa është e plotë, kontrollon nëse të gjitha dokumentacionet përkatëse për identifikimin dhe dokumentet e tjera zyrtare janë të bashkëngjitura dhe vërteton vlefshmërinë e dokumenteve zyrtare të bashkëngjitura. Më pas ai dërgon kërkesën, kopjet e dokumentacioneve identifikuese dhe të dokumentacioneve zyrtare të bashkëngjitura si dhe formularët përkatës të periudhave të sigurimit tek Zyra Zvicerane e Kompensimit. Për plotësimin e formularit informues institucioni kompetent shqiptar kërkon të dhëna në lidhje me periudhat e sigurimit për ata muaj gjatë të cilëve janë paguar kontribute pranë sigurimeve shqiptare të pensioneve. Zyra Zvicerane e Kompensimit mund të kërkojë nga institucioni kompetent i Shqipërisë ose drejtëpërdrejtë nga personi që paraqet kërkesën ose tek punëdhënësi apo institucione të tjera, vërtetime dhe informacione shtesë.

(3) Përjashtimisht nga paragrafi (1) dhe (2) i këtij neni, personat mund ta dorëzojnë kërkesën e tyre edhe direkt tek institucionet kompetente të shteteve kontraktuese. Në këtë rast institucioni kompetent mund të dërgojë dokumentacionin e pranuar tek institucioni kompetent i shtetit të vendbanimit të aplikuesve për ta kontrolluar dhe vërtetuar.

(4) Personat, të cilët jetojnë në një shtet të tretë dhe që kërkojnë përfitime për pension pleqërie, invaliditeti apo familjar sipas legjislacionit të Shqipërisë apo sipas legjislacionit zviceran, i drejtohen direkt institucionit kompetent.

(5) Për kërkesat për përfitime duhet të përdoren formularët e parashikuar në nenin 3, paragrafi (1).

Neni 8

Kompensimi i njëhershëm

- (1) Nëse shtetasit shqiptarë ose pasjetuesit e tyre duke u bazuar në Nenin 16 Paragrafet (3) dhe (6) të marrëveshjes, mund të zgjedhin midis caktimit të një pensioni ose të një kompensimi të njëhershëm, atëherë Zyra Zvicerane e Kompensimit iu bën të ditur njëkohësisht shumën, e cila do t'u jepej si pagesë e njëhershme në vend të pensionit. Po ashtu ajo u bën të ditur periudhat totale të sigurimit që janë marrë në konsideratë për llogaritjen.
- (2) Personi në fjalë duhet të ushtrojë të drejtën e zgjedhjes brenda 60 ditëve pas marrjes së njoftimit nga Zyra Zvicerane e Kompensimit.
- (3) Nëse personi të cilit i lind e drejta për përfitim, nuk ushtron të drejtën e zgjedhjes brenda afatit të parashikuar, atëherë Zyra Zvicerane e Kompensimit i cakton kompensimin e njëhershëm.
- (4) Mbi këtë pasojë ligjore personi të cilit i lind e drejta, vihet në dijeni nëpërmjet sqarimit të përmendur në Paragrafin (1).

Neni 9

Dërgimi i vendimeve

Institucioni kompetent i dërgon direkt personit aplikues vendimin e tij për të drejtën e përfitimit së bashku me njoftimin për të drejtat e tij ligjore si dhe i dërgon një kopje sipas Nenit 2 institucionit kompetent të shtetit tjetër kontraktues.

Neni 10

Pagesat e përfitimeve

- (1) Përfitimet do të paguhen nga institucionet përgjegjëse për pagesat sipas dispozitave ligjore të zbatueshme për këta institucione. Institucioni kompetent ka të drejtë të zgjedhë institucionin financiar për pagesën e përfitimit. Data që do të merret për bazë për kursin e këmbimit, do të përcaktohet në një marrëveshje midis institucionit kompetent dhe institucionit financiar.

KREU IV

Dispozita të ndryshme

Neni 11

Kërkesat për kontributet e paguara dhe kthimin mbrapsht të përfitimeve të paguara padrejtësisht

- (1) Pretendimet në lidhje me përfitimet e paguara padrejtësisht do të kompensohen sa të jetë e mundur sipas nenit 30 të marrëveshjes bazë.
- (2) Nëse një pretendim për kthim mbrapsht të përfitimeve nuk mund të kompensohet i gjithi ose kompensohet vetëm pjesërisht, shuma e debisë së mbetur, do të kërkohet sipas nenit 31 të marrëveshjes bazë.

(3) Institucioni kompetent i cili dëshiron të ushtrojë pretendimin e tij në shtetin tjetër kontraktues, i paraqet zyrës ndërlidhëse të shtetit tjetër kontraktues një kërkesë për ushtrim pretendimi për kthimin e përfitimeve duke i bashkëlidhur edhe urdhërin e ekzekutimit. Kërkesa duhet të përmbajë:

3.1 Emrin, mbiemrin, adresën dhe të dhënat e tjera të nevojshme për identifikimin e personit fizik ose juridik respektivisht për identifikimin e personit të tretë në posedim të të cilit gjenden asetet e tij;

3.2 Emërtimin, adresën dhe të dhëna të tjera të nevojshme për identifikimin e institucionit i cili parashton kërkesën për kthimin eshumës;

3.3 Llojin e pretendimit dhe shumën e kërkuar;

3.4 Datën e lëshimit të urdhërit të ekzekutimit.

(4) Zyra ndërlidhëse pranë së cilës është paraqitur një kërkesë për ushtrim pretendimi, nuk është e detyruar të japë ndihmën e parashikuar sipas nenit 31 të marrëveshjes, nëse kërkesa për ekzekutim u referohet pretendimeve që kanë lindur për ngjarje që kanë ndodhur më herët se pesë vite më parë ose nëse ushtrimi i pretendimit duket i perealizueshëm.

(5) Ekzekutimi bëhet në valutën e shtetit kontraktues në të cilën është ekzekutuar kërkesa. Zyra ndërlidhëse pranë së cilës është paraqitur kërkesa për ekzekutim, transferon shumën e realizuar tek institucioni kompetent i cili ka bërë kërkesën.

(6) Zyra ndërlidhëse pranë së cilës është paraqitur kërkesa për ekzekutim, tërheq nga debitori të gjitha shpenzimet që janë kryer për ekzekutimin. Zyra ndërlidhëse në këtë rast procedon në përputhje me legjislacionin në fuqi në lidhje me pretendime të ngjashme në po atë shtet. Nëse kostot e ekzekutimit nuk mund t'i merren debitorit, ato mund të zbriten nga shumat e realizuar. Nëse kostot e tejkalojnë shumën e realizuar ose nëse ekzekutimi nuk është realizuar, këto kosto do të merren përsipër nga institucioni kompetent që ka paraqitur kërkesën për ekzekutim.

(7) Ndihma Juridike në zbatim të nenit 30 dhe nenit 31 të marrëveshjes duhet të ofrohet pa pagesë.

(8) Me kërkesë të institucionit kompetent të njërit shtet kontraktues, shteti tjetër kontraktues i ofron atij të gjitha informacionet që i shërbejnë ekzekutimit. Për të siguruar këto informacione zyra ndërlidhëse e shtetit tjetër kontraktues ushtron të gjitha kompetencat që i takojnë në përputhje me dispozitat ligjore dhe administrative për ekzekutimin e pretendimeve të ngjashme në vendin e saj. Kërkesa për informacion përmban të gjitha të dhënat relevante për identifikimin e personit fizik ose juridik të cilit i referohen të dhënat që do të jepen, si edhe llojin dhe shumën e pretendimit tek i cili bazohet kërkesa.

Neni 12

Dëmshpërblimi

Në rastet e parashikuara në Paragrafin 2 të Nenit 32 të marrëveshjes, institucioni kompetent i shtetit kontraktues në territorin e të cilit ndodhet debitori, ia mbledh gjithë shumën e pretenduar debitorit, nëse kjo kërkohet nga institucioni kompetent i shtetit tjetër kontraktues.

Neni 13

Statistikat

Zyrat ndërlidhëse të të dy shteteve kontraktuese për çdo vit kalendarik i përcjellin njëra-tjetrës statistika mbi personat e dërguar dhe pagesat për përfituesit në zbatim të marrëveshjes. Statistikat përmbajnë, të ndara sipas llojit të përfitimeve, numrin e përfituesve dhe shumën totale të përfitimeve të paguara.

Neni 14

Detyrimi për njoftim

(1) Përfituesit sipas legjislacionit të njërit shtet kontraktues, të cilët jetojnë në territorin e shtetit tjetër kontraktues, i bëjnë të ditur institucionit kompetent të gjitha ndryshimet e situatës së tyre personale apo familjare, të gjendjes së tyre shëndetësore ose aftësisë së tyre për punë, të cilat mund të ndikojnë të drejtat apo detyrimet e tyre të parashikuara në legjislacionin e përmendur në nenin 2 të marrëveshjes apo bazuar në dispozitat e marrëveshjes dhe këto të dhëna i japin drejtpërsëdrejti ose përmes ndërmjetësimit nga institucionet e përmendura në nenin 2.

(2) Institucionet kompetente e njoftojnë njëri-tjetrin drejtpërsëdrejti ose përmes zyrave ndërlidhëse për të gjitha ndryshimet sipas paragrafit (1) të këtij neni, të cilat atyre u bëhen të ditura.

Neni 15

Dokumentacioni mjekësor dhe kontrollet mjekësore

(1) Institucioni kompetent i njërit shtet kontraktues i përcjell institucionit kompetent të shtetit tjetër kontraktues pa pagesë të gjitha dokumentet mjekësore që ka në dispozicion në lidhje me invaliditetin e personit, i cili ka paraqitur kërkesën për përfitim ose aktualisht është përfitues.

(2) Kur paraqitet kërkesa për përfitim, institucioni kompetent i shtetit të vendbanimit të përhershëm i vë në dispozicion pa pagesë institucionit kompetent të shtetit tjetër kontraktues formularin e dakordësuar (raportin mjekësor).

Neni 16

Kontrolle mjekësore dhe informacione shtesë

2

(1) Nëse një person, i cili ka aplikuar apo përfiton pension invaliditeti sipas legjislacionit të njërit shtet kontraktues, banon në territorin e shtetit tjetër kontraktues, atëherë institucioni kompetent në çdo kohë mund t'i kërkojë zyrës ndërlidhëse të këtij shteti kontraktues, të ndërmarrë kontrollë mjekësore ose të mbledhë informacione shtesë sipas legjislacionit të zbatueshëm për të. Institucioni kompetent ka të drejtë të zgjedhë mjekun i cili do të kryejë kontrollin mbi personin që ka aplikuar apo është përfitues i një pensioni.

(2) Nëse institucioni kompetent i një shteti kontraktues kërkon një raport mjekësor shtesë për një person i cili ka paraqitur kërkesë apo është përfitues i një pensioni, atëherë institucioni kompetent i shtetit tjetër kontraktues, kryen kontrollin e nevojshëm mjekësor në territorin në të cilin banon personi në fjalë, sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas tarifave të zbatueshme në shtetin ku banon personi.

(3) Pas paraqitjes së një fature të detajuar me dokumentacionin justifikues, shpenzimet e përmendura në paragrafin 2 do të rimbursohen nga institucioni kompetent që ka kërkuar kontrollin. Detajet e procedurave të rimbursimit do të përcaktohen nga zyrat ndërlidhëse në mirëkuptim të ndërsjelltë.

Neni 17 **Shpenzimet administrative**

Shpenzimet administrative të kryera nga zbatimi i marrëveshjes dhe i kësaj marrëveshjeje administrative, do të mbulohen nga institucionet kompetente dhe zyrat ndërlidhëse të ngarkuara për zbatim.

Neni 18 **Hyrja në fuqi**

(1) Kjo marrëveshje administrative hyn në fuqi në ditën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes dhe do të jetë e vlefshme deri sa të jetë e vlefshme marrëveshja.

(2) Kjo marrëveshje administrative mund të plotësohet apo ndryshohet me shkrim nga autoritetet kompetente të të dy shteteve kontraktuese në mirëkuptim të ndërsjelltë.

BËRË në Tiranë më 18 Shkurt 2022 në dy kopje origjinale në gjuhën gjermane dhe në gjuhën shqipe, ku të dy tekstet janë njëllloj autentike.

Për Ministrinë e Financave

dhe Ekonomisë

Delina Ibrahimaj

Për Zyrën Federale

për Sigurimet Shoqërore

Alain Berset

**Verwaltungsvereinbarung
zur Durchführung des Abkommens
zwischen der Republik Albanien
und der Schweizerischen Eidgenossenschaft
über Soziale Sicherheit**

In Anwendung von Artikel 20 Absatz 1 des Abkommens vom
18. Februar 2022 zwischen der Republik Albanien und der Schweizerischen
Eidgenossenschaft über soziale Sicherheit, nachstehend als "Abkommen"
bezeichnet, haben die zuständigen Behörden, nämlich

für Albanien

das Ministerium für Finanzen und Wirtschaft

und

für die Schweizerische Eidgenossenschaft

das Bundesamt für Sozialversicherungen

die nachstehenden Bestimmungen vereinbart:

Titel I Allgemeine Bestimmungen

Artikel 1 Begriffe

Die in dieser Verwaltungsvereinbarung verwendeten Begriffe haben die gleiche Bedeutung wie im Abkommen.

Artikel 2 Verbindungsstellen und zuständige Träger

(1) Verbindungsstellen im Sinne von Artikel 20 Absatz 1 des Abkommens sind:

1.1 in der Schweiz:

für die Alters- und Hinterlassenenversicherung:
die Schweizerische Ausgleichskasse in Genf (nachstehend als "Schweizerische Ausgleichskasse" bezeichnet),
für die Invalidenversicherung:
die IV-Stelle für Versicherte mit Wohnsitz im Ausland in Genf;

1.2 in Albanien:

Die Sozialversicherungsanstalt (Instituti i Sigurimeve Shoqërore).

(2) Zuständige Träger sind:

2.1 in der Schweiz:

- für die Alters- und Hinterlassenenversicherung:
die zuständige Ausgleichskasse,
- für die Invalidenversicherung:
die zuständige IV-Stelle;

2.2 in Albanien:

Die Sozialversicherungsanstalt (Instituti i Sigurimeve Shoqërore).

Artikel 3 Formulare und elektronischer Datenaustausch

(1) Die zuständigen Behörden beider Vertragsstaaten oder mit ihrer Ermächtigung die Verbindungsstellen legen im gegenseitigen Einvernehmen die für die Durchführung des Abkommens erforderlichen Formulare fest.

(2) Zwecks Erleichterung der Durchführung des Abkommens können die Verbindungsstellen Massnahmen zum elektronischen Austausch von Daten vereinbaren.

Titel II Anwendbare Rechtsvorschriften

Artikel 4 Entsendungen

(1) In den Fällen nach Artikel 7 Absatz 1 des Abkommens bescheinigen die in Absatz 2 dieses Artikels genannten Träger des Vertragsstaates, dessen Rechtsvorschriften weiterhin angewandt werden, auf Antrag, dass die betreffende Person diesen Rechtsvorschriften unterstellt bleibt.

Die Bescheinigung enthält deren Geltungsdauer und ist gemäss Abkommen der Nachweis dafür, dass die Person nicht der obligatorischen Versicherung des anderen Vertragsstaates unterstellt ist.

(2) Die Bescheinigung nach Absatz 1 wird auf dem vorgesehenen Formular ausgestellt, und zwar:

2.1 in der Schweiz von der zuständigen Ausgleichskasse der Alters-, Hinterlassenen- und Invalidenversicherung;
En ce qui concerne la Suisse, de l'Office fédéral des assurances sociales.

2.2 in Albanien von der Sozialversicherungsanstalt (Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

(3) Anträge auf Verlängerung der Entsendungsdauer über die im Abkommen vorgesehene Dauer von zwei Jahren hinaus, sind vor Ablauf der Gültigkeit der Bescheinigung bei der zuständigen Behörde des Vertragsstaates einzureichen, von dessen Gebiet aus die Person entsandt worden ist. Befürwortet diese Behörde den Antrag, so verständigt sie sich durch Schriftwechsel mit der zuständigen Behörde des anderen Vertragsstaates und teilt den vereinbarten Entscheid der antragstellenden Person und den beteiligten Trägern ihres Landes mit.

Artikel 5 Beschäftigte in diplomatischen und konsularischen Vertretungen

(1) Personen gemäss Artikel 10 Absatz 2 des Abkommens erbringen den Nachweis, dass sie weiterhin den Rechtsvorschriften des Staates unterstehen, von dem sie entsandt worden sind, mittels eines Ausweises in Übereinstimmung mit dem Wiener Übereinkommen vom 18. April 1961 über die diplomatischen Beziehungen und dem Wiener Übereinkommen vom 24. April 1963 über konsularische Beziehungen.

(2) Zur Ausübung des in Artikel 10 Absätze 3 und 4 des Abkommens vorgesehenen Wahlrechts erklären

- 2.1 die in der Schweiz Beschäftigten ihre Wahl bei der Sozialversicherungsanstalt Instituti e Sigurimeve Shoqërore in Albanien;
- 2.2 die in Albanien Beschäftigten ihre Wahl bei der Eidgenössischen Ausgleichskasse in Bern.

(3) Wählen die in Artikel 10 Absätze 3 und 4 des Abkommens erwähnten Beschäftigten die Rechtsvorschriften des vertretenen Vertragsstaates, so wird ihnen vom zuständigen Träger beziehungsweise den zuständigen Trägern dieses Vertragsstaates eine Bescheinigung darüber ausgestellt, dass sie diesen Rechtsvorschriften unterstellt sind. Diese Bescheinigung ist den zuständigen Stellen des Vertragsstaates vorzulegen, in dem die Beschäftigung ausgeübt wird.

(4) In den Fällen nach Artikel 10 Absatz 7 des Abkommens melden sich die betreffenden Personen beim zuständigen Träger des Beschäftigungsstaates an, und zwar bei Aufnahme ihrer Erwerbstätigkeit beziehungsweise bei Inkrafttreten des Abkommens, wenn sie in diesem Zeitpunkt ihre Erwerbstätigkeit bereits ausüben, aber nicht versichert sind.

Artikel 6 Familienangehörige

In den Fällen nach Artikel 13 Absatz 2 des Abkommens melden sich die betreffenden Personen bei der kantonalen Ausgleichskasse des Kantons, in dessen Gebiet sie zuletzt gewohnt haben.

Titel III

Bestimmungen zu den Leistungen

Artikel 7

Einreichung und Bearbeitung der Leistungsanträge

(1) Personen, die in der Schweiz wohnen und die Alters-, Invaliden- oder Hinterlassenenleistungen nach den albanischen Sozialversicherungsgesetzen beanspruchen, reichen ihren Antrag direkt bei der Schweizerischen Ausgleichskasse ein. Diese vermerkt auf dem Formular das Eingangsdatum, prüft den Antrag auf Vollständigkeit, kontrolliert, ob alle erforderlichen Ausweise und amtlichen Dokumente beigelegt sind und bestätigt die Gültigkeit der beigelegten amtlichen Dokumente. Sie leitet dann den Antrag, Kopien der beigelegten Ausweise und Dokumente sowie ein Informationsformular betreffend die Versicherungszeiten an den zuständigen Träger, oder, falls dieser nicht bekannt ist, an die in Artikel 2 erwähnte Verbindungsstelle von Albanien weiter. Diese Stelle kann von der Schweizerischen Ausgleichskasse weitere Auskünfte und Bescheinigungen verlangen oder solche unmittelbar bei den Antragstellern oder durch Vermittlung der Verbindungsstelle von Albanien bei den Arbeitgebern oder bei anderen Einrichtungen einholen.

(2) Personen, die in Albanien wohnen und Leistungen der schweizerischen Alters-, Hinterlassenen- oder Invalidenversicherung beanspruchen, reichen ihren Antrag direkt bei der Sozialversicherungsanstalt (Instituti i Sigurimeve Shoqërore) in Albanien ein. Diese vermerkt auf dem Formular das Eingangsdatum, prüft den Antrag auf Vollständigkeit, kontrolliert, ob alle erforderlichen Ausweise beigelegt sind und bestätigt die Gültigkeit der beigelegten amtlichen Dokumente. Sie leitet dann den Antrag, Kopien der beigelegten Ausweise und Dokumente sowie ein Informationsformular betreffend die Versicherungszeiten an die Schweizerische Ausgleichskasse weiter. Zwecks Ausfüllung des Informationsformulars verlangt der zuständige albanische Träger Angaben betreffend Versicherungszeiten für diejenigen Monate, während derer Beiträge an die albanische Rentenversicherung bezahlt wurden. Die Schweizerische Ausgleichskasse kann vom zuständigen Träger in Albanien weitere Auskünfte und Bescheinigungen verlangen oder solche unmittelbar bei den Antragstellern oder den Arbeitgebern oder bei anderen Einrichtungen einholen.

(3) In Abweichung von Absatz 1 und 2 dieses Artikels können Personen den Antrag auch direkt bei den zuständigen Trägern der Vertragsstaaten einreichen. In diesem Fall kann der zuständige Träger den Antrag und die erhaltenen Unterlagen beim Sozialversicherungsträger des Wohnsitzlandes prüfen und bestätigen lassen.

(4) In einem Drittstaat wohnhafte Personen, die Alters-, Invaliden- oder Hinterlassenenleistungen nach den Sozialversicherungsgesetzen von Albanien oder der schweizerischen Alters-, Hinterlassenen- oder Invalidenversicherung beanspruchen, wenden sich direkt an den zuständigen Träger.

(5) Für die Leistungsanträge sind die nach Artikel 3 Absatz 1 vorgesehenen Formulare zu verwenden.

Artikel 8 Einmalige Abfindung

(1) Können Staatsangehörige von Albanien oder deren Hinterlassene gestützt auf Artikel 16 Absätze 3 und 6 des Abkommens zwischen der Ausrichtung der Rente oder einer Abfindung wählen, so teilt ihnen die Schweizerische Ausgleichskasse zugleich den Betrag mit, der ihnen gegebenenfalls anstelle der Rente gewährt würde. Ferner gibt sie die Gesamtdauer der berücksichtigten Versicherungszeiten an.

(2) Die berechnigte Person muss ihr Wahlrecht innerhalb von 60 Tagen nach Erhalt der Mitteilung der Schweizerischen Ausgleichskasse ausüben.

(3) Übt die berechnigte Person ihr Wahlrecht innerhalb dieser Frist nicht aus, so spricht ihr die Schweizerische Ausgleichskasse die Abfindung zu.

(4) Diese Rechtsfolge wird der versicherten Person in der in Absatz 1 erwähnten Mitteilung zur Kenntnis gebracht.

Artikel 9 Artikel 9

Der zuständige Träger stellt seine Verfügung über den Leistungsanspruch mit einer Rechtsmittelbelehrung versehen direkt der antragstellenden Person zu und übermittelt dem zuständigen Träger des anderen Vertragsstaates gemäss Artikel 2 eine Kopie.

Artikel 10 Auszahlung der Leistungen

Die Leistungen werden durch die leistungspflichtigen Träger nach den für sie geltenden Rechtsvorschriften ausbezahlt. Das vom zuständigen leistungspflichtigen Träger frei gewählte Finanzinstitut legt den Umrechnungskurs fest.

Titel IV Verschiedene Bestimmungen

Artikel 11 Einforderung von nicht bezahlten Beiträgen und zu Unrecht erbrachten Leistungen

(1) Forderungen betreffend nicht geschuldete Leistungen werden soweit als möglich auf dem Wege der Einbehaltung nach Artikel 30 des Abkommens ausgeglichen.

(2) Forderungen betreffend nicht geschuldete Leistungen werden soweit als möglich auf dem Wege der Einbehaltung nach Artikel 30 des Abkommens ausgeglichen.

(3) Der zuständige Träger, der eine Forderung im anderen Vertragsstaat betreiben möchte, stellt bei der Verbindungsstelle des anderen Vertragsstaates einen Antrag auf Betreibung und legt diesem einen Vollstreckungstitel bei. Der Antrag enthält:

3.1 Namen, Anschrift und sonstige sachdienliche Angaben zur Identifizierung der betreffenden natürlichen oder juristischen Person bzw. des Dritten, in dessen Besitz sich ihre Vermögenswerte befinden;

3.2 Namen, Anschrift und sonstige sachdienliche Angaben zur Identifizierung des Trägers, der ein Ersuchen um Betreibung einreicht;

3.3 Art und Höhe der Forderung;

3.4 Datum der Zustellung des Vollstreckungstitels.

(4) Die Verbindungsstelle, bei der ein Antrag auf Betreibung eingereicht wurde, ist nicht verpflichtet, die in Artikel 31 des Abkommens vorgesehene Unterstützung zu gewähren, wenn sich das Betreibungersuchen auf mehr als fünf Jahre alte Forderungen bezieht oder eine Betreibung aussichtslos erscheint.

(5) Die Betreibung erfolgt in der Währung des Vertragsstaates, in welchem die Betreibung durchgeführt wird. Die Verbindungsstelle, bei der ein Antrag auf Betreibung eingereicht wurde, überweist den gesamten von ihr eingetriebenen Betrag an den Träger, der den Antrag gestellt hat.

(6) Die Verbindungsstelle, bei der ein Antrag auf Betreibung eingereicht wurde, zieht beim Schuldner der Forderung sämtliche Kosten ein, die ihr im Zusammenhang mit der Betreibung entstehen; sie verfährt dabei nach den für vergleichbare Forderungen geltenden Rechts- und Verwaltungsvorschriften in ihrem Staat. Können die Betreibungskosten nicht direkt beim Schuldner eingezogen werden, können diese Kosten vom eingetriebenen Betrag abgezogen werden. Übersteigen die Kosten den eingetriebenen Betrag oder war die Betreibung nicht erfolgreich, werden sie durch den Träger übernommen, der den Antrag auf Betreibung gestellt hat.

(7) Die bei der Anwendung von Artikel 30 und 31 des Abkommens geleistete Amtshilfe wird unentgeltlich gewährt.

(8) Auf Antrag des zuständigen Trägers des einen Vertragsstaats erteilt der andere Vertragsstaat diesem alle Auskünfte, die für die Betreibung einer Forderung von Nutzen sind. Zur Beschaffung dieser Auskünfte übt die Verbindungsstelle des anderen Staats die Befugnisse aus, die ihr nach den Rechts- und Verwaltungsvorschriften für die Betreibung entsprechender Forderungen zustehen, die in ihrem eigenen Staat entstanden sind. Das

Auskunftsersuchen enthält alle relevanten Angaben für die Identifizierung der betreffenden juristischen oder natürlichen Person, auf die sich die zu erteilenden Auskünfte beziehen, sowie Angaben über Art und Höhe der dem Ersuchen zugrunde-liegenden Forderung.

Artikel 12 Schadenersatz

In den Fällen des Artikels 32 Absatz 2 des Abkommens zieht der Träger des Vertragsstaates, in dessen Gebiet sich der Schuldner befindet, die Gesamtforderung beim Schuldner ein, sofern der Träger des anderen Vertragsstaates es beantragt.

Artikel 13 Statistiken

Die Verbindungsstellen beider Vertragsstaaten übermitteln einander für jedes Kalenderjahr die Statistiken über die in Anwendung des Abkommens gewährten Entsendungen und Zahlungen an die Berechtigten. Die Statistiken enthalten, nach Leistungsart getrennt, die Zahl der Berechtigten und die Gesamthöhe der gewährten Leistungen.

Artikel 14 Informationspflicht

(1) Die Empfängerinnen oder Empfänger von Leistungen nach den Rechtsvorschriften des einen Vertragsstaates, die im Gebiet des anderen Vertragsstaates wohnen, teilen dem zuständigen Träger alle Änderungen betreffend ihre persönliche oder familiäre Lage, ihren Gesundheitszustand oder ihre Arbeits- und Erwerbsfähigkeit, welche ihre Rechte oder Pflichten aufgrund der in Artikel 2 des Abkommens aufgeführten Rechtsvorschriften sowie aufgrund der Bestimmungen des Abkommens beeinflussen können, entweder direkt oder durch Vermittlung der in Artikel 2 bezeichneten Stellen mit.

(2) Die Träger unterrichten einander direkt oder durch Vermittlung der in Artikel 2 Absatz 1 bezeichneten Stellen über alle Änderungen nach Absatz 1, die ihnen mitgeteilt werden.

Artikel 15 Medizinische Unterlagen und ärztliche Untersuchungen

(1) Der Träger des einen Vertragsstaates übermittelt dem Träger des anderen Vertragsstaates kostenlos alle ihm zur Verfügung stehenden medizinischen Unterlagen zur Invalidität der Person, die eine Leistung beantragt hat oder bezieht.

(2) Bei Einreichen des Leistungsantrages stellt der Träger des Wohnsitzstaates dem Träger des andern Vertragsstaates das vereinbarte Formular (Arztbericht) kostenlos zu

Artikel 16 Zusätzliche Untersuchungen und Auskünfte

(1) Wohnt die Person, die eine Invalidenrente nach den Rechtsvorschriften des einen Vertragsstaates beantragt hat oder bezieht, im Gebiet des anderen Vertragsstaates, so kann der zuständige Träger jederzeit die in Artikel 2 bezeichnete Stelle dieses Vertragsstaates ersuchen, ärztliche Untersuchungen vorzunehmen oder weitere von den für ihn geltenden Rechtsvorschriften verlangte Auskünfte einzuholen. Es bleibt dem zuständigen Träger freigestellt, die Person, die eine Rente beantragt hat oder bezieht, durch eine Ärztin oder einen Arzt seiner Wahl untersuchen zu lassen.

(2) Ersucht der Träger eines Vertragsstaates um einen zusätzlichen ärztlichen Bericht für eine Person, die eine Leistung beantragt hat oder bezieht, so veranlasst der Träger des anderen Vertragsstaates die erforderliche Untersuchung im Gebiet, in dem die betreffende Person wohnt, gemäss den für ihn geltenden Vorschriften und nach den Tarifen, die im Wohnstaat anwendbar sind.

(3) Nach Vorlage einer detaillierten Abrechnung mit Belegen werden die in Absatz 2 erwähnten Kosten vom ersuchenden Träger erstattet. Die Einzelheiten des Rückerstattungsverfahrens werden durch die Verbindungsstellen in gegenseitigem Einvernehmen festgelegt.

Artikel 17 Verwaltungskosten

Die aus der Durchführung des Abkommens und dieser Vereinbarung entstehenden Verwaltungskosten werden von den mit der Durchführung beauftragten Stellen getragen.

Artikel 18 Inkrafttreten

(1) Diese Verwaltungsvereinbarung tritt gleichzeitig mit dem Abkommen in Kraft und gilt ebenso lange wie dieses.

(2) Diese Verwaltungsvereinbarung kann von den zuständigen Behörden der beiden Vertragsstaaten im gegenseitigen Einvernehmen ergänzt oder geändert werden.

Geschehen zu Tirana am 18. Februar 2022 in zwei Urschriften in deutscher Sprache und in albanischer Sprache, wobei beide Texte in gleicher Weise verbindlich sind.

**Für das Ministerium
Finanzen und Wirtschaft**

Delina Ibrahimaj



**Für das Bundesamt
für Sozialversicherungen**

Alain Berset

